

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSË NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

SCC-R-07-0490

Në padinë e

- 1) [REDACTED], Gjakovë
Përfaqësuar nga [REDACTED], avokat nga Gjakova
- 2) [REDACTED], Gjakovë
- 3) [REDACTED], Gjakovë
- 4) [REDACTED], Gjakovë

Paditësit

kundër

NSH " [REDACTED] ", Gjakovë

I Padituri

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetari i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, lidhur me ankesën e Paditësit dhe kërkesës për rishikimin e aktvendimit të DHPGJS-së së datës 23 prill 2008, SCC-07-0490, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 gusht 2010, lëshon këtë

AKTVENDIM

Kërkesa për rishikim dhe ankesa, që të dyja të parashtruara nga Paditësi i 1-rë, [REDACTED], hedhen poshtë.

Arsyet ligjore:

Më 23 prill 2008, DHPGJS-ja hodhi poshtë padinë për bashkëpronësi të Paditësve si e papranueshme, në të cilën ata po kërkonin vërtetimin e bashkëpronësisë së tyre për pronat e paluajtshme përkatëse. Aktvendimi ishte dërguar tek Paditësi i 1-rë më 9 maj 2008.

Në kërkesën për rishikim, të parashtruar nga Paditësi i 1-rë pranë DHPGJS-së më 17 qershor 2008, Paditësi kërkon që aktvendimi të rishikohet, të priset dhe të vazhdohet me procedurën gjyqësore duke lëshuar aktvendimin mbi bazën meritore.

Kërkesa për rishikim është e papranueshme dhe andaj refuzohet.

Mjeti juridik për rishikimin e aktvendimit të ndërmarrë nga nën-panelet e gjyqtarëve të DHPGJS-së me panelin e plotë të gjyqtarëve siç parashihet në Nenin 13.4 të UA të UNMIK-ut 2006/17, në fuqi në datën e parashtrimin të kërkesës, nuk parashihet më nga RREG e UNMIK-ut 2008/4 dhe UA 2008/6 në fuqi që nga 1 janari i vitit 2009 (dhe jo nga 31 maji i vitit 2008, siç pretendohet në kërkesën për rishikim). Gjegjësisht, as RREG e UNMIK-ut 2008/4 e as UA e UNMIK-ut 2008/6 nuk përmban një dispozitë kalimtare se si të trajtohen kërkesat tanimë në pritje për rishikim. Duhet të nënvizohet se pas hyrjes në fuqi të instrumenteve ligjore të lartpërmendura nuk ka më organ ligjor ekzistues i cili do të kishte të drejtë t'i trajtonte mjetet e tilla juridike siç është rishikimi. Si rregull parimor i sistemit ligjor evropian, rregullat e procedurës që gjinden në legjisllacionin e ri hyjnë drejtpërdrejt në fuqi edhe për sa i përket lëndëve në pritje, derisa nuk ka dispozita kalimtare

që theksojnë ndryshe (SCC-R-08-0006; SCC-R-08-0028 etj.). Andaj rishikimi i aktvendimeve të marra madje edhe para datës 31 dhjetor 2008 nuk është më i mundur. Si rrjedhojë, kërkesa e Paditësit duhet të hedhet poshtë.

Së fundi, madje edhe sipas supozimit se ligji i vjetër do të ishte ende në fuqi, përfundimi do të ishte i njëjtë:

Neni 13.4 i UA së UNMIK-ut 2006/17 theksoi: "Aktgjykimi apo vendimi i marrë nga paneli i gjyqtarëve gjithashtu mund të rishikohet nga Dhoma e Posaçme nëse pala kërkon rishikimin e tillë. Çdo aktgjykim apo vendim i marrë nga Dhoma e Posaçme pas rishikimit të tillë do të vërtetohet apo do të refuzohet aktgjykimin a vendimin e marrë nga paneli i gjyqtarëve. Kërkesa për rishikim të tillë bëhet brenda 1 (një) muaji nga data e dorëzimit të aktgjykimit apo vendimit të panelit."

Megjithatë kërkesa për rishikim ishte parashtruar pas afatit dhe prandaj nuk i ka përmbushur kërkesat formale të përcaktuara në këtë dispozitë. Afati kohor për parashtrimin e kërkesës për rishikim kishte kaluar më 10 qershor 2008 (shih Nenin 10.1 [b] UA e UNMIK-ut 2006/17), ndërsa kërkesa për rishikim ishte parashtruar më 17 qershor 2008.

Së bashku me kërkesën për rishikim, Paditësi parashtroi një ankesë me anë të cilës e kundërshtoi aktvendimin e sipërpërmendur të DHPGJS-së, duke u bazuar në shkeljen e supozuar të dispozitave të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, vërtetimin e supozuar të gabuar ose vetëm vërtetimin e pjesshëm të fakteve, dhe në zbatimin e supozuar të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale.

Ankesa është e papranueshme.

RREG e UNMIK-ut 2002/13 dhe UA e UNMIK-ut 2006/17, që të dyja në fuqi deri më 31 dhjetor 2008, nuk parashohin të drejtën për të bërë ankesë

kundër aktvendimeve të DHPGJS-së. Prandaj, aktvendimet e DHPGJS-së të lëshuara para datës 31 dhjetor 2008 nuk mund të apelojnë pasi që ligji në fuqi nuk kishte paraparë një mjet juridik të tillë, dhe, përveç kësaj, nuk kishte një autoritet ligjor ekzistues të tillë në atë kohë që do të kishte të drejtë të vendoste për ankesat. Përfundimisht, nuk ekziston "e drejta e patjetërsueshme për t'u ankuar ndaj organit të shkallës së parë". Në veçanti, Neni 6 dhe Neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të shikohet nga DHPGJS-ja. Sipas RREG së UNMIK-ut 1999/24 "Për Ligjin në fuqi në Kosovë", Neni 1.3.(b), nuk mundëson të drejtën për t'u ankuar ndaj çfarëdo aktvendimi të shkallës së parë në rastet civile (SCC-R-05-0004 etj.).

Nuk është dashur që të merret vendimi mbi shpenzimet.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it	nënshkrimi
Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it	nënshkrimi
Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it	nënshkrimi
Tobias Lapke, Regjistruer i Përkohshëm i EULEX-it	nënshkrimi